

L I G J
Nr.8452, datë 28.1.1999

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7602, DATË 9.9.1992 “PËR
GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8361
DATË 1.7.1998 DHE LIGJIN NR.8421, DATË 28.10.1998**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7602, datë 9.9.1992 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8361, datë 1.7.1998 dhe ligjin nr.8421, datë 28.10.1998, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 pika “b”, pas fjalëve “dhe Kryetarin e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit”, shtohen fjalët “dhe Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë”.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e parë fjalët “dhe në nenin 3 të këtij ligji”, zëvendësohen me fjalët “dhe në nenin 3, paragrafi i parë i këtij ligji”.

- Paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Personaliteteve të përmendura në nenin 2 pika “b” të këtij ligji, në raste të veçanta, me vendim të Këshillit të Ministrave, mund t’u ruhet edhe banesa”.

- Paragrafi i fundit shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2310, datë 4.2.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**